Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 398/01
Datë 06.11.2015

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 mbi Kualifikimet Kombëtare të datës 7 nëntor 2008 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 35/2014 të datës 20. 11. 2014 mbi Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me nenet 4, 7, 10, 11, 16 dhe 17, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve me datë 06.11.2015 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Për ri akreditimin dhe ri validimin e Qendrës për Aftësim Profesional Prishtinë për periudhën: 06.11.2015 deri 06.11.2018 për të ofruar këto kualifikime:

1.1 Asistent Administrativ, niveli i 3 i KKK;

Ri akreditimi dhe ri validimi i institucioni/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:

Kushtet:

- Të avancohet me teknologjinë për inskenimin(simulimin) e rolit të asistentit administrativ. Një pjesë e orëve ti kushtohet simulimit të roleve në lidhje me punë të zakonshme të zyrtarit administrativ.
- Të nënshkruhen marrëveshje bashkëpunimi me kompani, ku kandidatët mund të kryejnë një pjesë të punës praktike me qëllim të plotësimit të pjesës teorike dhe ushtrimeve në klasë dhe të integruar me punën praktike në kompani.
- Të avancohet në ndërtimin e një sistemi për menaxhim të cilësisë.
- Harmonizimi dhe rishikimi i paketës mësimore dhe instrumenteve të vlerësimit bazuar ne standardet profesionale. Në kuadër të moduleve të përshihet hyrje në kontabilitet dhe marketing(kryesisht për trendet digjitale)
- Prezantimi i planit të trajnimeve për tërë vitin edhe pse është format modular, prapë se prapë duhet të ketë një orar për tërë vitin lidhur me kohështrirjen e ligjëratave.

- Të zhvillohet plani i zhvillimit personal për trajnerët e QRAP i harmonizuar me MPMS

  (Afati kohor i këtyre kushteve: 30.09.2016)

1.2. Instalues i ngrohjes qendrore, niveli i 3 i KKK;

Ri akreditimi dhe ri validimi i institucioni/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:

Kushtet:

- Zhvillimi i manualit të cilësisë (ku do të jenë të zhvilluara politikat, proceset dhe proceduarat e punës)
- Ridizajnimi i testeve të vlerësimit
- Harmonizimi i statistikave në raportin e Vetëvlerësimit
- Përshkrimi i dëshmive në raportin e vetëvlerësimit të jetë më përmbajtjesor
- Të avancohet procesi në zgjerimin e rrjetit të bashkëpunimi me kompani dhe institucione me veprimtari të ngjashme
- Rishikimi dhe riformatimi i listave të nënshkrimit
- Protokollimi dhe arkivimi i dokumenteve që lëshohen nga Qendra
- Mbyllja e vendeve të zbrazëta në librin e protokollit që përmban të dhënat për kandidatet e Certifikuar
- Zhvillimi i formularëve për monitorimin e procesit të mësimdhënies
- Pjesëmarrësve në trajnim tu ofrohet nga një doracak trajnimi

  (Afati kohor i këtyre kushteve: 30.09.2016)

1.3. Instalues i ujësjellësit dhe kanalizimit, niveli i 3 i KKK;

Ri akreditimi dhe ri validimi i institucioni/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:

Kushtet:

- Zhvillimi i manualit të cilësisë (ku do të jenë të zhvilluara politikat, proceset dhe proceduarat e punës)
- Ridizajnimi i testeve të vlerësimit
- Harmonizimi i statistikave në raportin e Vetëvlerësimit
- Përshkrimi i dëshmive në raportin e vetëvlerësimit të jetë më përmbajtjesor
- Të avancohet procesi në zgjerimin e rrjetit të bashkëpunimi me kompani dhe institucione me veprimtari të ngjashme
- Rishikimi dhe riformatimi i listave të nënshkrimit
- Protokollimi dhe arkivimi i dokumenteve që lëshohen nga Qendra

- Mbyllja e vendeve të zbrazëta në librin e protokollit që përmban të dhënat për kandidatet e Certifikuar
- Zhvillimi i formularëve për monitorimin e procesit të mësimdhënies
- Pjesëmarrësve në trajnim tu ofrohet nga një doracak trajnimi

(Afati kohor i këtyre kushteve: 30.09.2016)

1.4. Teknologji Informative dhe e Komunikimit, niveli i 2 i KKK;

Ri akreditimi dhe ri validimi i institucioni/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:

Kushtet:

- Kompjuterët kanë të instaluar sistemin operativ Windows 7 dhe paketën e aplikacioneve të MS Office 2010 të pa licencuar. Rekomandohet që sistemi operativ dhe pako e aplikacionit të MS Office të jenë të licencuar.
- Kandidatët janë në nivele të ndryshme dhe është paksa e papërshtatshme që trajnerja në të njëjtën orë të merret me grupe të ndryshme të kandidatëve, ku një kandidat është në modulin e parë, një tjetër në të tretin e kështu me radhë. Rekomandohet që nëse është e mundur grupi të jetë sa më homogjen duke organizuar grupe që janë në modulin e njëjtë.
- Edhe përkundër orarit të përshtatshëm, fondit të mjaftueshëm të orëve si dhe përkushtimit maksimal të trajnerës, mbajtja e provimeve në formatet teorik dhe praktik duket se vë ngarkesë të padëshiruar tek kandidatët duke qenë se ata/ato mësojnë teknologjinë informative për zbatim praktik. Po ashtu nëse kandidati nuk e kalon testin final, atëherë nuk dihet cila është procedura për mundësinë e ri testimit. Rekomandohet që të shqyrtohen mundësitë që testet/provimet të mbahen vetëm në pjesën praktike si dhe të ketë procedurë të shkruar për mënyrën e ri testimit.
- QRAP ka trajnuar dhe vazhdon të trajnojë një numër të konsiderueshëm të kandidatëve dhe nuk ekziston ndonjë bazë e të dhënave elektronike e mirëfilltë. Rekomandohet që të krijohet një bazë e strukturuar e të dhënave elektronike që do të mundësonte ruajtjen dhe mirëmbajtjen e të dhënave të kandidatëve në mënyrë shumë më të mirë dhe efikase.
- Edhe përkundër faktit që kandidatit i ofrohet edukimi profesional në fushën e teknologjisë informative ashtu që ai/ajo të shtojë mundësitë e gjetjes së punës, çalon komunikimi i QRAP me bizneset meqë kjo është përgjegjësi e QRP (Qendrës Rajonale për Punësim). Rekomandohet që të shtohet ky komunikim me qellim të rritjes së mundësisë së punësimit të kandidatit/tes.
- QRAP posedon dhomë të serverit por nuk posedon: intranet e as ueb sajt te vetin! Rekomandohet që të kenë një hapësirë në kuadër të faqes së MPMS dhe të mund të administrojnë vetë, ose edhe të kenë një faqe të përbashkët për të gjitha qendrat.

- Aktualisht QRAP nuk kanë të drejtë të kenë më shumë se një trajner. Në mungesë të trajnerës angazhohet kandidati/tja më i/e mirë për zëvendësim. Rekomandohet që QRAP të ketë dy trajner të TIK.
- Mirëmbajtja teknike e kompjuterëve, pajisjeve periferike dhe e pajisjeve të rrjetit është e centralizuar nga MPMS. Rekomandohet që mirëmbajtja teknike të ofrohet nga QRAP.
- Salla e kompjuterëve ka 8 kompjuter për nevoja të kandidatëve, një kompjuter për nevoja të trajnerit dhe një printer. Në sallë vërehet që ka rrjet të hapësirës lokale (LAN) porse jo të gjithë kompjuterët janë të lidhur në rrjet (Internet). Rekomandohet që të gjithë kompjuterët të lidhen në rrjet funksional përmes të cilit rrjet kandidatët të kenë qasje në Internet dhe projektori të jetë gjithnjë prezent në sallë.
- Çdo fund vit përpilohen planet e zhvillimit për të gjithë trajnerët në DAP dhe aty përcaktohet më pastaj ecuria e zhvillimit profesional. QRAP nuk ka mjete të alokuara për zhvillimin profesional të trajnerës të TIK. Trajnerja nuk është e certifikuar për Windows 7 dhe MS Office 2010. Rekomandohet që të alokohet buxhet i posaçëm për zhvillimin profesional të trajnerit, si edhe trajnerja të certifikohet me ECDL versionin 5. Rekomandohet që të përpilohet procedura si dhe plani i veprimit për certifikim të trajnerit për TIK nga menaxhmenti i QRAP.
- Detyra të shtëpisë nuk kanë kandidatët. Çdo modul ka një detyrë e cila realizohet në klasë. Rekomandohet që të përpilohen detyra të shtëpisë ashtu që kandidati të jetë aktiv me procesin e mësimit për aq kohë sa zgjat trajnimi.
- Listat ekzistuese të vijueshmërisë mbahen nga trajneri i cili mban shënim me + (plus) dhe - (minus) prezencën apo mos prezencën e kursantit. Rekomandohet që në listat e vijueshmërisë kursantët të nënshkruhen si dëshmi për prezencën e tij/saj në trajnim për aq sa zgjat trajnimi.
- Meqë QRAP është një vatër e mirëfilltë edukative ku merren njohuri profesionale kandidatët nuk dallohen nga nëpunësit e organizatës si dhe mungojnë shenjat bazike te hapësirave te tualeteve apo zyrave përkatëse dhe sallave te trajnimit. Rekomandohet që të vendoset një standard në identifikimin e nëpunësve nga kandidatët dhe palët e treta si edhe të riorganizohet sinjalizimi i orientimit në hapësirën e brendshme të objektit.
- Trajnerja për TIK ne te njëjtën hapësirë te trajnimit dhe ne te njëjtën kohë mban trajnim për TIK por edhe për elektronikë industriale. Rekomandohet qe trajnimi për TIK te mbahet veçmas nga trajnimi për elektronikë industriale.
- Në formatin ekzistues të trajnimit QRAP nuk e ka të përfshirë praktikën në mjedis të biznesit. Ndaj duke parë disponimin e kandidatëve te cilët favorizojnë mundësinë qe krahas trajnimit ne qendër te kenë mundësinë edhe te mbajtjes se praktikës se paku një javore ne ndonjë institucion publik do te ishte e mirë se ardhur qe menaxhmenti te diskutoje këtë mundësi me personelin kompetent në MPMS.
- Komunikimi i zyrtarëve të qendrës me organizata dhe persona të ndryshëm realizohet në masë edhe përmes postës elektronike private. Rekomandohet që stafi i QRAP të përdorin e-Postën zyrtare për komunikim elektronik të brendshëm dhe të jashtëm.

- Literatura e përdorur nga kandidatët në ambientet e qendrës nuk mund të përdoret edhe në shtëpi. Nëse kandidatët dëshirojnë ta marrin literaturën duhet ta fotokopjojnë me mjetet e veta financiare kur dihet që kandidatët janë punëkërkues. Rekomandohet që literatura të ju jepet në shfrytëzim gjatë kohës së trajnimit ose në formë elektronike në format të përhershëm.
- Pas përfundimit të kursit trajnerët përgatisin dosjen komplete të kandidatit ku përfshihen rezultatet në të gjitha modulet e arritura. Certifikata e nënshkruar dhe e protokolluar i dorëzohet kandidatit. Rekomandohet që datëlindja të hiqet nga certifikata meqë bëhet fjalë për të dhënë të ndjeshme sipas ligjit me nr. 03/L-172 të R. së Kosovës.

  (Afati kohor i këtyre kushteve: 30.09.2016)

3. Arsyetim

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit, Këshilli Drejtues i AKK-së merr këtë vendim bazuar në rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Ri validimin e kualifikimit, Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Ri akreditimin e Institucionit i cili ofron dhe/ose vlerëson dhe lëshon kualifikime të aprovuara dhe këto rekomandime janë të mbështetura në fakte dhe dokumente si në vijim:

- Aplikacioni për Validim të Kualifikimit/Modulit;
- Aplikacioni për Akreditim si Institucionit Ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit;
- Raporti i Vetë-vlerësimit;
- Vizita në institucionin/ofruesin aplikues, dhe
- Dokumente tjera shtesë.

3.1 Pala e pakënaqur me vendimin, ka drejtë ankese në organet e shkallës së dytë. Ankesa bëhet përmes organit të shkallës së parë.

4. Kushtet e parashtruara për aprovim dhe akreditim duhet të përmbushen në afatin e caktuar nga AKK, në rastin kur institucioni/ofruesi nuk i përmbushë këto kritere, AKK ka të drejtë tërheqjen e aprovimin dhe akreditimit.

5. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit të tij.

6. Vendimi i dërgohet:

- Qendrës për Aftësim Profesional Prishtinë;
- AKK.

Nën- Kryetari i KD së AKK-së
Anton Gojani